



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor
Nr: 04-351/02-45206
Dt. 04.04.2024
Prizren

DREJTORATI PËR URBANIZËM dhe PLANIFIKIM HAPËSINOR, me kërkesë së Avzilatit Xhemajli B.I. me emër tregtar “RIMED” nga Prizreni me seli në rrugën “Anif Muji” Prizren, e në bazë të neneve 3alineja 1 pikat 1.1,1.4,1.7 ,1.10,1.16, 1.17,1.20,1.24 dhe të nenit 4 alineja 1 pika 1.2 ,e lidhur me nenin 5 alineja 1 pika 1.1 si dhe nenit 14.alineja 1 pika 1.1 si dhe ne lidhje me nenin 15 pika 1.1 dhe nenit 19. pika 2. të Ligjit për ndërtim nr.04/L-110,dhe në harmoni me dispozitat e nenit 3 alineal pikat 1.1,1.3,1.5,1.6,1.7,dhe 1.8 e lidhur me nenet 4,5,9,11,16 paragrafi 1.2 dhe 5 të Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit nr.04/L-066 ,Neni 6 ,paragrafi 6.4 dhe 6.9 i Ligjit për Trashëgimisë Kulturore nr.02/L-88 ; nenit 85 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të neneve 13,14,27,32 paragrafi 3 dhe 4 si dhe neneve 44,45,46,47,124 e në lidhje me nenin 125 Ligjit per Procedurën e Përgjithshme Administrative nr. 05/L-031, si dhe konform nenit 33 pika 13, dhe konform nenit 23 dhe 27 pika 6.1, e Rregullores për taksa Komunale nr.001/011-99275 dt.30.06.2022 si dhe Vendimit për përcaktimin e taksës administrative për lëshimin e lejes ndërtimore dhe tarifat për rregullimin e infrastrukturës në territorin e qytetit të Prizrenit nr.01/011-41141 të dt.10.04.2014, merr kete:

VENDIM
(për Leje Ndërtimore)

Kjo Leje ndërtimore i lëshohet:			
Emri:	Avzilatit Xhemajli B.I. me emër tregtar “RIMED”		
Adresa:	“Anif Muji”-Prizren		
Telefoni:	-/-	Emaili:	//
Emri i projektit	Objekt kolektiv– me shumë funksione		
Emri i projektuesit	N.T.SH. “RIMED”		
Adresa:	Prizren		
Telefoni:	-/-	Emaili:	-/-

Me këtë Vendim, aplikuesit për leje ndërtimore **Avzilatif Xhemajli B.I. me emër tregtar "RIMED"** me seli në rrugën **"Anif Muji"** me etazhitet **2B+P+3+Ph; 2B+S+P+3+Ph; B+S+P+3+Ph dhe S+P+3+Ph** me numer ngastres **P-71813068-04561-2; 04562-0; 04563-0; 07938-2; 07939-0; 07941—10 Z.K.Prizren.**

	Për punët ndërtimore në vijim	
Adresa:	Prizren "Anif Muji"	
Zonat (t) Kadastrale	<p>Lokacioni i ndërtimit gjendet në Zonën Kadastrale Prizren</p> <p>Objekti – banim me shumë funksione do të ndërtohet në ngastrat kadastrale me nr. P-71813068-04561-2; 04562-0; 04563-0; 07938-2; 07939-0; 07941-10 Z.K.Prizren. me sipërfaqe sipas kopjes së planit është S=10,057 m²</p> <p>Sipërfaqe bruto bodrumit -2 është S=1836.74m². Sipërfaqe neto bodrumit -2 është S=1740.65m². Sipërfaqe bruto bodrumit -1 është S=2215.18m². Sipërfaqe neto bodrumit -1 është S=2081.33m². Sipërfaqe bruto e suterrenit është S=2244.08m². Sipërfaqe neto e suterrenit është S=2070.37m². Sipërfaqe bruto e përdhese është S=2888.82m². Sipërfaqe neto e përdhese është S=2560.63m². Sipërfaqe bruto e katit I është S=2881.92m². Sipërfaqe neto e katit I është S=2550.11m². Sipërfaqe bruto e katit II është S=3204.47m². Sipërfaqe neto e katit II është S=2831.78m². Sipërfaqe bruto e katit III është S=3344.16m². Sipërfaqe neto e katit III është S=2948.09m². Sipërfaqe bruto e katit Penthouse është S=2102.03m². Sipërfaqe neto e katit Penthouse është S=1842.07m². Sipërfaqja br. e boksit të shkalleve është S=185.53 m² Sipërfaqja nt. e boksit të shkalleve është S=150.23 m²</p> <p>Sipërfaqe bruto e objektit është S=20,902.93m². Sipërfaqe neto e objektit është S=18,775.26m²</p>	GPS Koordinatat:

- Është miratuar taksa administrative për lëshimin e lejes ndërtimore në shumën prej **88,145.82 Euro.**
- Parallogaria e vlerës së objektit sipas këtij dokumentacioni teknik është në shumën prej **10,210,414.20 €.**

Lloji i ndërtimit të propozuar: Ndërtimi i ri <input checked="" type="checkbox"/> Rindërtim <input type="checkbox"/> Riparim <input type="checkbox"/>
Kategoria e ndërtimeve të propozuara: Kategoria I <input checked="" type="checkbox"/> Kategoria II <input type="checkbox"/>
A përfshin kërkesa ndryshim të destinimit? Po <input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/>
Perdorimi i propozuar: objekt me shumë funksione

Me këtë vendim, poseduesit të lejes ndërtimore **Avzilatif Xhemajli B.I. me emër tregtar “RIMED”** nga Prizreni me seli në rrugën **“Anif Muji”** me etazhitet **2B+P+3+Ph;2B+S+P+3+Ph;B+S+P+3+Ph dhe S+P+3+Ph .**

Poseduesi i Lejes Ndërtimore është i obliguar që:

- Të fillojë me punët ndërtimore brenda një (1) viti nga data e dhënies së kësaj leje ndërtimore. Në rast se nuk fillohet me ndërtim brenda këtij afati atëherë mund të bëhet kërkesa për vazhdim të lejes ndërtimore brenda afatit të vlefshmërisë së lejes ndërtimore;
- Të vendosë tabelen informuese në vendndërtim me informatat e mëposhtme:
 - Informata mbi Lejen Ndërtimore
 - Informatat mbi projektuesin
 - Informata mbi kontraktuesin
 - Prezantimi grafik i dukjes së ndërtimit
 - Të rrethoj vend ndërtimin (punishten)
- Të sigurojë që kontraktuesi në vendndërtim posedon dokumentet e mëposhtme:
 - Një kopje të kësaj leje ndërtimore;
 - Një kopje e të gjitha dokumenteve të ndërtimit që janë nënshkruar ose vulosur si të “APROVUAR” nga organi kompetent;
 - Projektin kryesor me të gjitha faza për nevojat të realizimit të ndërtimit;
 - Dokumentacionin që tregon konformitetin e produkteve të ndërtimit dhe pajisjeve me kërkesat rregullative, dhe me dokumentet e aprovuara të ndërtimit;
 - Librin dhe ditarin ndërtimor, që duhet të përmbajë regjistër të hollësishëm ditor të të gjitha punëve ndërtimore, përfshirë të dhëna të shkruara dhe skematike, që dokumentojnë: datën, vendin dhe rezultatet e testeve të kryera në materialet ose punët ndërtimore;
 - Përshkrim të problemeve të hasura gjatë ndërtimit dhe inspektimit dhe mënyrën se si janë zgjidhur si dhe;
 - Kartelën e miratuar nga Drejtoria e Inspektionit – inspektoriatit i ndërtimit e cila është e nevojshme për aplikim për certifikatë të përdorimit;
 - Të dorëzoj njoftim inspektoratit të Organit Kompetent për fillimin e ndërtimit së paku shtatë (7) ditë para fillimit të punëve ndërtimore;
 -
 - Të njoftoj organin kompetent për të kryer inspektimet siç kërkohet me ligj, dhe akte nënligjore. Këto inspektime nuk e lirojnë aplikuesin për leje ndërtimore dhe/ose arkitektin apo inxhinierin e licencuar përgjegjës për sigurimin e inspektimeve adekuate dhe mikëqyrje ditore të punëve ndërtimore;

- Të njoftoj organin kompetent për ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga kproejktuesi. Poseduesi i Lejes Ndërtimore duhet të njoftojë organin kompetent për të gjitha ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuara nga projektuesi përveq në rast kur:
 - o Ndryshimet nuk janë në kundërshtin me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret teknike në fuqi;
 - o Ndryshimet në dimensionet e pjesëve të jashtme të ndërtimit nuk tejkalojnë 2% dhe zero presje një (0,1) metër por që nuk tejkalojnë vijën ndërtimore;
 - o Ndryshimet në organizimin e brendshëm janë në harmoni me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret teknike në fuqi;
- Të aplikojë për certifikatë të përdorimit pas përfundimit të punëve ndërtimore, në pajtim me Ligjin dhe aktet nënligjore.

A r s y e t i m

Aplikuesi **Avzilatif Xhemajli B.I. me emër tregtar "RIMED"** ka kërkuar nga organi kompetent **DUPH** lëshimin e Lejes Ndërtimore për **objektin – me shumë funksione**. Pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit, si dhe bazuar në Ligjin për Ndërtim Nr. 04/L-110, Ligjin Nr. 02/L-28 të Procedurës Administrative dhe dispozitat tjera të ligjit në fuqi, u konstatua se janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara ligjore për lëshimin e Lejes Ndërtimore, andaj u vendos si në dispozitiv.

Kjo Leje Ndërtimore bazohet në shqyrtimin e provave:

- Njoftim për plotësim të dokumentacionit 04-353/01-137392 dt.05.01.2024
- Pëlqimi nga "KEDS-i",
- Pëlqimi nga Kom."Hidroregjioni Jugor",
- Pëlqimi nga Telekom i Kosovës – PTK-ja,
- Pëlqim nga "Ekoregjioni",
- Pëlqim nga Kompania Rajonale e Ujitjes-"Dugagjini"
- Aktvendim nga Drejtoria e Emergjencës dhe Sigurisë,
- Vërtetimi nga sektori i menagjimit të mbeturinave,
- Vendim për Leje Mjedisore Komunale,
- Katër kopje të projektit kryesor dhe CD.

Udhëzimi juridik: pala e pakënaqur me këtë aktvendim, përmes kësaj Drejtorie me ankesë mund t'i drejtohet Ministrisë së Ambientit dhe Planifikimit Hapësinorë, brenda afatit prej 30 ditësh duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij Vendimi.

DREJTORIA E URBANIZMIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR

Nr.04-351/02-45206 dt.04.04.2024

Bashkëpunëtore profesionale:

Egzona Morina-Thaqi ark.dipl.



DREJTORI

Pranverim Berisha jur.